



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR  
STRUKTURA E INTEGRIMIT DHE NDIHMËS TË HUAJ

PROJEKT - VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, Date 22 / 12 / 2021

Për miratimin e Projektit:

*“Ekonomia e Gjelbërt si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën”*

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr.107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” si dhe Ligjin Nr. 93/2015 “Për Turizmin”.

**Kërkojmë:**

1. Miratimin e projektit “Ekonomia e Gjelbërt si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën” të financuar nga Programi Programi për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin RDPA Faza II Programit me një vlerë 13 492 400 lekë me TVSH.
2. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës dhe Struktura e Integrimit Evropian dhe Ndihmës të Huaj.
3. Vlera e TVSH-së të projektit prej 2 698 480 lekë të planifikohet në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2022.

**Për Bashkinë Dibër:**

Drejtori i Planifikimit dhe  
Zhvillimit të Territorit  
Elvis MANGA

Struktura e Integrimit Evropian  
dhe Ndihmës të Huaj  
Ardit VRANIÇI

Drejtoria Ekonomike  
Lorenc CIBAKU

Sektori Juridik  
Elona LUSHA

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË  
Shkëlqim MURRJA



Nr. 364 Prot.

Tirana, 20 December 2021

**Subject: Grant Scheme on Regional Development and Cohesion – Application nr. RDPA4FA001 “Smart Green Economy Possibilities for Radomira Touristic Village”**

**To: Mr. Shkëlqim Murrja  
Mayor, Dibër Municipality**

**To the attention of: Mr. Dritan Agolli  
Executive Director of the Albanian Development Fund (ADF)  
Mr. Gentl Kerri  
Deputy Director and Director of the Regional Development Department at the Albanian Development Fund (ADF)**

Honourable Mr. Murrja,

We thank you for submitting a full application for the call in the frame of the Scheme on Regional Development and Cohesion.

We are pleased to inform you that your application has been evaluated by the evaluation committee established by ADF and has been provisionally selected to be awarded a grant.

As indicated in the Call for Proposals, the provisionally selected applicants shall provide the following supporting documents:

- The decision of the Municipal Council of lead applicant and co-applicant, if any, to implement the Project for which the RDPA grant is awarded, with mandate to the mayor to sign the grant contract;
- For investment projects, a confirmation of the ownership on the immovable property or other documentary evidence proving the legal right to use the relevant public property.

Supporting documents must be delivered in original copy, or certified copy or scanned documents (stamps, signatures and dates shall be readable) of the original documents above mentioned.

To further proceed with the preparation of the grant contract, it is necessary for the application to be completed as follows:

- Most of procurement documents need to be further elaborated so the procurement to be launch immediately after grant contract signature;
- There is no technical project since only layout and rendering has been delivered. In general, if the technical project is not matured, the applicant should submit ToR for design phase, which is missing as well;
- The budget should be re-check and re-designed in order to comply with cost-effectiveness principle;



- Sustainability of project results and Municipality's engagement in ensuring sustainability should be further elaborated in the application format.

The required supporting documents and the completed version of the application shall be included in the grant contract.

All required documents as mentioned above shall be delivered to the Albanian Development Fund through an envelope with the words "Regional Development and Cohesion Grant Scheme – Application nr. RDP4FA001 "Smart Green Economy Possibilities for Radomira Touristic Village" within 13<sup>th</sup> of January 2022.

If you need further information, please contact the ADF contact point [ldashi@albaniandf.org](mailto:ldashi@albaniandf.org) or RDPA contact point [erinda.toska@rdpa.al](mailto:erinda.toska@rdpa.al).

Please keep note that this letter does not give you the right to be awarded a grant. The right to be awarded a grant shall be ensured once both parties will sign the grant contract and it will solely depend on the terms of the contract.

Respectfully,  
Doris Van Dam  
SHÇIPËR  
Executive Director of RDPA Foundation

## PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL NË SHQIPËRI

Thirrje për Aplikime për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

### Shtojca A – Formulari i Aplikimit për Grant – Formulari i Aplikimit të Plotë

Afati i dorëzimit të aplikimit

**15 Nëntor 2021 at 16:00**

Titulli i projektit:	Ekonomia e Gjelbërt si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën.
Vendndodhja(et) e projektit:	<i>Radomirë, Njësia Administrative Kala e Dodës</i>
Emri i aplikantit kryesor	Bashkia Dibër
Emri i bashkë-aplikantit <sup>1</sup>	-
Emri i partnerit në projekt <sup>2</sup>	ANRD

Dosja Nr.	
-----------	--

(Vetëm për përdorim zyrtar)

<sup>1</sup> Emri i çdo bashkë-aplikanti të shkruhet në rresht më vete.

<sup>2</sup> Emri i çdo partneri projekti të shkruhet në rresht më vete.

## FORMULARI I APLIKIMIT TË PLOTË PËR GRANT<sup>3</sup>

Duhet të dorëzohet nga aplikantët kryesorë të zgjedhur paraprakisht

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Titulli i Thirrjes për Aplikime	PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL NË SHQIPËRI
Emri i Aplikantit Kryesor	Bashkia Dibër
Titulli i projektit	Ekonomia e Gjelbërt si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën.
Vendndodhja(et) e projektit	Radomirë, Njësia Administrative Kala e Dodës
Kohëzgjatja totale e projektit (në muaj)	10 muaj
Shuma e kërkuar	13 492 400 lekë + (Bashkëfinancimi Bashkia Dibër 2 698 480 lekë)
Objektiv(at) e projektit	<p><i>Objektivi i përgjithshëm:</i></p> <p>Të ofrojë mundësi për zhvillimin e ekonomisë lokale përmes Eko-Turizmit, nëpërmejt zhvillimit të shërbimeve dhe produkteve turistike të fashatit Radomirë si një mundësi për banorët e zonës.</p> <p><i>Objektivat specifikë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>I. Vlerësimi i mundësive të Eko-turizmit në zonën e Radomirës përmes përmirësimit të shërbimeve lokale pjesë të shtigjeve aktuale turistike.</li> <li>II. Zhvillimi i turizmit mbështetur në Komunitet dhe promovimi i Eko-turizmit nëpërmejt promovimit të shtigjeve turistike të aritshme për turistët në fashatin Radomirë.</li> </ol>
Grup(et) <sup>4</sup> e synuara	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fermerët vendas dhe familjet e tyre.</li> <li>- Sipërmarrjet e vogla që operojnë në fushën e turizmit, Eko-turizmit dhe bujqësisë.</li> <li>- Shoqatat e zhvillimit bujqësor dhe lokal.</li> <li>- Përfaqësuesit lokal të Bashkisë Dibër.</li> <li>- Institucionet lokale në Dibër.</li> </ul>
Përfituesit përfundimtarë <sup>5</sup>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Banorët e zonës.</li> </ul>

<sup>3</sup> Aplikimi i plotë përbëhet nga ky formular i plotë aplikimi, nga buxheti (Shtojca B), si dhe dokumentet shtesë të kërkuara sipas paragrafit 2.2.4 të këtij formulari aplikimi.

<sup>4</sup> "Grupet e synuara" janë grupet/entitetet që do të përfitojnë drejtpërsëdrejti nga projekt në nivel objektiv të projektit.

<sup>5</sup> "Përfituesit përfundimtarë" janë ata që do të përfitojnë nga projekti në një afat më të gjatë kohor në nivel shoqërie apo sektori në përgjithësi.

## PROJEKTI

### 2.1 Executive Summary

#### The importance of the project context:

Radomira village is located in Kala e Dodës Administrative Unit. It is known as one of the most popular touristic destinations in Dibër, with Korab Mountain and the Natural Monuments/Resources that characterize it. Kala e Dodës Administrative Unit have about 2,845 inhabitants. People who live in this mountainous area can be described as a rural population, with relatively low incomes and high rate of unemployment<sup>6</sup>. Since 2018, Radomira is part of the 100 Villages Program as a village with a high touristic potential.

*Based on it's Passport as a touristic village there is a high potential for sustainable development for Eco-Tourism in the area<sup>7</sup>.* Radomira offers a number of opportunities for tourists, opportunities from adventure tourism (hiking, climbing, mountain biking), to traditional food in the host structures and cultural heritage. Based on the General Local Plan of the Municipality of Dibër, this village is presented as one of the villages that have all the characteristics to become one of the most visited touristic destinations by national and foreign tourists<sup>8</sup>.

Radomira has been traditionally known for dairy products that have been produced and processed for years in this area. Currently dairy products are processed in simple handicraft dairies only in Kala e Dodës. Livestock breeding has been a significant economic activity for the rural population in Albania throughout years, especially for those living in mountainous areas. This economic activity has created a special lifestyle for farmers and special traditions for the Radomira area. Farmers migrate to the mountains area during the summer for better pastures and create temporary settlements there, called Stane. This is one of the oldest traditions that is still practiced today, albeit to a lesser extent. The style of construction of shepherds' stalls is simple and has not changed over the centuries making it very unique and traditional.

Craft work is another way to generate income for the locals in the area. Craft products are produced for individual needs and as souvenirs for visitors. The locals have an old tradition of producing traditional clothes (garments) made by wool. These traditional craft activities provide a source of income for the local population.

All these traditions in the field of cuisine and cultural heritage that Radomira has today, combined with Mount Korab and its natural resources give Radomira all the characteristics of a tourist village with a relatively high potential for sustainable local development.

#### Problems that are needed to be addressed by the project:

Despite the possibilities as a touristic destination, a number of problems continue to be present in Radomira. This problems has limited the tourism potential and the development of tourism in this area. Some of the problems that this area face are:

- Lack of information about touristic sites.
- Lack of accommodation structures.
- Limited capacities about human resources.
- Lack of support infrastructure.
- Lack of promotional activities.

All these problems have made it difficult to profit from this opportunities and to create opportunities for sustainable economic development in this area. Based on the Social Plan of the Municipality of Dibër, this area nowadays is characterized by a relatively high rate of unemployment, economic difficulties, emigration and in some cases negative phenomena such as cannabis cultivation<sup>9</sup>. Sustainable tourism development is considered as one of the most efficient

<sup>6</sup> Based on the Social Plan of Dibër Municipality 2018-2021

<sup>7</sup> The passport of Development Potentials of Radomirë Village 2018

<sup>8</sup> General Local Plan of Dibër Municipality 2018-2030

<sup>9</sup> Social Plan of Dibër Municipality 2018-2021

mechanisms to develop and use natural resources, cultural and historical values of the village for the communities that live there. What is noticeable is that the communities living in these remote mountainous areas don't consider tourism as an economic development opportunity especially for employment. This problem makes this area appear as an area which offers few alternatives. As a result of these problems, tourism continues to be an underdeveloped sector with many limitations.

The current range of recreational activities such as hiking, riding and skiing is limited in the area. There are few marked touristic trails and there is a lack of accurate up-to-date maps, as well as local signers are almost non-existent. The local infrastructure, especially the village-to-village connection in general is not in good conditions. Housing conditions are generally modest. However, improvements are happening day by day in this area.

During 2018-2019, the number of non-residents and foreign visitors increased with 13% compared to 2016 in this area<sup>10</sup>. There is a growing interest from local and foreign tourists to visit the village, Korab Mountain and the Natural Park that lies next to it. Municipality of Dibër and some foreign donors has supported some guest houses and enterprises during this years. Consequently the number of these houses is too small to meet the demand for accommodation, especially for groups who prefer hiking and adventure sport along the entire length of Korab Mountain.

*The objective of the project is providing new opportunities for the development of the local economy through development of Eco-Tourism touristic services and touristic products in Radomirë village as an opportunity for the community in this area. The project will also focus on développement and promoting new tourism products in the Radomira touristic village with direct involvement of local communities.*

#### Impact of project activities on target groups and final beneficiaries:

The target groups of the project are Local farmers and their families, Enterprises operating in the field of tourism, Local agricultural development associations, Local Institutions, Local and foreign tourists.

Local farmers and their families - The project activities will have a direct impact on their daily economic activity by improving the market access for their products through the promotion of the area and agro-tourism products that Radomira offers. Small enterprises operating in the field of tourism, Eco-tourism and agriculture - In addition to capacity building in this field, the project will provide direct support for the establishment of new enterprises in the field of agro-tourism, creating opportunities for economic growth in the area. Local Agricultural Development Associations - The project will coordinate its activities with local organizations operating in the field of agro-tourism in the area. Local Representatives of the Municipality of Dibër - The project will create opportunities for promoting activities which will come as an alternative for sustainable local and regional development. Domestic and foreign tourists - the project will create tools and opportunities for tourists to identify and visit the main attractions that the area offer.

A comprehensive method will be used in order to achieve the project objectives. The project considers very important the development and promotion of new touristic products in this alpine area with the direct involvement of farmers and the local community. In order to increase the number of tourists in this area it is important for local farmers to learn how to improve customer service, as a basis for development of the tourism industry.

During drafting the concept idea, the project team has identified and took into account the needs of the target groups and final beneficiaries, as well as the challenges that hinder the fulfillment of these needs. Socio-economic development of Radomira and target groups is affected directly by unemployment, high dependence on agricultural income and living in remote rural areas.

The project team conceived it by taking into account the great social and environmental challenges and opportunities that the area offer. They identified and developed in collaboration with local partners a presentation about current opportunities, challenges and projects to better understand and plan the development of the area from a tourism perspective. The aim

---

<sup>10</sup> Based on the Strategic Plan of tourism 2018-2028

was to avoid parallel activities and to identify complementary activities that would support the full development of the project target area through the development and implementation of joint activities.

#### The specific objectives of the project:

This project will be based on previous activities implemented by Municipality of Dibër, especially on the good experience of creating/adapting and training for service delivery. It will also focus on renewing the traditional culture of local communities. The project will be based on previous activities implemented by the Ministry of Environment and Tourism in Albania in relation to nature tourism and cultural tourism offerings. This project create the opportunity for residents to orchestrate their local development through a participatory and decision-making approach.

Through this project, the Municipality of Dibër aims to orient the tourism sector towards these results:

- i. Valorization of Eco-tourism opportunities in the Radomira area through the improvement of local services part of the current tourist trails.
- ii. Development of community-based tourism and promotion of Eco-tourism through the promotion of tourist trails accessible for tourists in the village of Radomirë.

## **2.2 Përmbledhje Ekzekutive**

### Rëndësia e kontekstit të projektit:

Radomira shtrihet Njësinë Administrative Kala e Dodës dhe njihet gjerësisht si një ndër destinacionet turistike më të njohura në Dibër, me Malin e Korabit dhe Monumentet Natyrore që e karakterizojnë. Në Njësinë Administrative Kala e Dodës jetojnë rreth 2,845 banorë. Banorët që jetojnë në këtë zonë malore të Bashkisë Dibër mund të përshkruhen si një popullsi rurale, me të ardhura relativisht të ulëta dhe me një shkallë papunësie relativisht të lartë<sup>11</sup>. Që prej vitit 2018 Radomira është pjesë e programit 100 fshatrat si një fshat me potencial relativisht të lartë turistik.

*Bazuar në Pasaportën e tij si një fshat turistik ekziston një potencial i lartë për zhvillimin e qëndrueshëm të Eko-turizmit në këtë zonë*<sup>12</sup>. Radomira ofron një numër mundësish për turistët që nga turizmi i aventurës (hiking, alpinizëm, çiklizmi malor) deri tek ushqimet tradicionale në strukturat pritëse dhe trashëgimia kulturore. Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Dibër, ky fshat paraqitet si një ndër fshatrat i cili ka të gjitha karakteristikat dhe mundësitë për t'u kthyer në një ndër destinacionet turistike më të vizituara si nga turistët vendas ashtu edhe nga ato të huaj<sup>13</sup>.

Radomira ka qenë tradicionalisht e njohur për produktet e qumështit që janë prodhuar dhe përpunuar prej vitesh në zonë. Aktualisht produktet e qumështit përpunohen në baxho të thjeshta artizanale vetëm në Kalanë e Dodës. Mbarështimi i bagëtitve ka qenë një aktivitet domethënës ekonomik për popullsinë rurale në Shqipëri gjatë gjithë kësaj kohe, veçanërisht për ata që jetojnë në zonat malore. Ky aktivitet ekonomik ka krijuar një stil të veçantë jetese për fermerët dhe tradita të veçanta për zonën e Radomirës. Fermerët shtegtojnë në male gjatë verës për kullota më të mira dhe krijojnë vendbanime të përkohshme atje, të quajtura stane. Kjo është një nga traditat më afatgjata të cilat praktikohen edhe sot, edhe pse në një masë më të vogël. Stili i ndërtimit të staneve të barinjve është i thjeshtë dhe nuk ka ndryshuar me shekuj duke e bërë atë shumë unik dhe tradicional.

Puna artizanale është një tjetër mënyrë për të krijuar të ardhura për banorët vendas në zonë. Produktet artizanale prodhohen për nevoja individuale dhe si suvenire për vizitorët. Banorët vendas kanë tradita të vjetra të prodhojnë rroba (veshje) tradicionale të bëra prej leshi. Këto aktivitete tradicionale artizanale sigurojnë një burim të ardhurash për popullsinë vendase.

Të gjitha këto tradita në fushën e kulinarisë dhe trashëgimisë kulturore që sot Radomira ka, kombinuar me Malin e Korabit dhe burimet natyrore të saj i japin Radomirës të gjitha karakteristikat e një fshati turistik me një potencial relativisht të lartë

<sup>11</sup> Bazuar në Planin Social, Bashkia Dibër 2018-2021

<sup>12</sup> Pasaporta e Potencialeve Zhvillimore, Fshati Radomirë 2018.

<sup>13</sup> Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Dibër 2018-2030

për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

Problematikat që duhet të adresohen nga projekti:

Pavarsisht mundësive si një destinacion turistik një numër problematikash vazhdojnë të jenë prezente, të cilat kufizojnë potencialin turistik dhe të zhvillimit të turizmit në këtë zonë:

- Mungesa e informacionit turistik.
- Mungesa e strukturave akomoduese.
- Kapacitete të kufizuara të burimeve njerëzore.
- Mungesa e infrastrukturës mbështetëse.
- Mungesa e aktiviteteve promovuese.

Të gjitha këto problematika kanë bërë që mundësitë e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm nga turizmi të zbehen dhe të jenë tepër të kufizuara. Bazuar në Planin Social të Bashkisë Dibër, kjo zonë sot karakterizohet nga një shkallë papunësie relativisht e lartë, vështirësi ekonomike, emigracioni dhe në disa raste edhe fenomene negative si kultivimi i kanabisit<sup>14</sup>. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit konsiderohet si një nga mekanizmat më efikasë për të zhvilluar dhe vënë në përdorim të gjitha pasuritë natyrore, vlerat kulturore e historike të fshatit dhe komuniteteve që jetojnë atje. Ajo që vihet re është se për komunitetet që jetojnë në këto zona të thella malore, ka një mungesë vlerësimi për mundësitë e zhvillimit ekonomik që ofron turizmi, veçanërisht për punësimin duke e bërë atë të paraqitet si një zonë e cila ofron pak alternativa. Si rezultat i këtyre problematikave, turizmi vazhdon të mbetet një sektor i pazhvilluar dhe me shumë kufizime.

Oferta aktuale e aktiviteteve rekreative si hiking, ecje, dhe ski janë të kufizuara në këtë zonë. Ka pak shtigje turistike të markuara dhe vihet re mungesa e hartave të sakta dhe të azhornuara, si dhe tabelat e sinjalistika lokale pothuajse nuk egziston. Infrastruktura lokale, posaçërisht lidhja fshat me fshat në përgjithësi nuk është e mirë. Kushtet e strehimit janë përgjithësisht modeste, megjithatë po vihen re përmirësime ditë pas dite.

Gjatë viteve 2018-2019, numri i vizitorëve jorezidentë, të huaj u rrit me rreth 13% krahasuar me 2016 në këtë zonë<sup>15</sup>. Ekziston një interes në rritje nga turistët vendas dhe të huaj për të vizituar fshatin, Malin e Korabit dhe parkun natyror që shtrihet pranë tij. Falë ndërhyrjes dhe përpjekjeve të bëra nga Bashkia Dibër dhe donatorë të huaj, disa shtëpi pritjeje janë përshtatur për të funksionuar si të tilla. Rrjedhimisht numri i këtyre shtëpive është mjaft i vogël për të pëmbushur kërkesën për akomodim, veçanërisht për grupet që preferojnë shëtitje në të gjithë gjatësinë e Malit të Korabit.

*Ky projekt ka si qëllim që të ofrojë mundësi për zhvillimin e ekonomisë lokale përmes Eko-Turizmit, nëpërmejt zhvillimit të shërbimeve dhe produkteve turistike të fshatit Radomirë si një mundësi për banorët e zonës. Projekti do të përqëndrohet gjithashtu zhvillimin dhe promovimin e produkteve të reja turistike në fshatin turistik të Radomirës me përfshirjen e drejtpërdrejtë të komuniteteve lokale.*

Impakti i aktiviteteve të projektit mbi target grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtar:

Grupet e synuara të projektit janë fermerët vendas dhe familjet e tyre, sipërmarrjet që operojnë në fushën e turizmit, shoqatat lokale të zhvillimit bujqësor, Institucionet Lokale, Turistët vendas dhe ato të huaj.

Fermerët vendas dhe familjet e tyre – Aktivitet e projektit do të kenë një impakt të drejtpërdrejtë në aktivitetin e tyre të përditshëm ekonomik duke përmirësuar aksesin në treg të produkteve nëpërmjet promovimit të zonës dhe produkteve agroturistike që Radomira ofron. Sipërmarrjet e vogla që operojnë në fushën e turizmit, Eko-turizmit dhe bujqësisë – Projekti nëpërmejt ngritjes të kapaciteteve në këtë fushë do të ofrojë dhe suport të drejtpërdrejt për ngritjen e sipërmarrjeve të reja në fushën e agro-turizmit duke krijuar mundësi për ngritjen e ekonomive të reja lokale në zonë. Shoqatat lokale të zhvillimit bujqësor – Projekti do të bashkërendojë aktivitetet e tij me aktivitetet dhe objektivat e organizatave lokale që operojnë në fushën e agro-turizmit në zonë. Përfaqësuesit lokal të Bashkisë Dibër – Projekti do të krijojë mundësitë për nxitjen e aktiviteteve të cilat do të vijnë si një alternativë për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal. Turistët vendas

<sup>14</sup> Plani Social i Bashkisë Dibër 2018-2021

<sup>15</sup> Bazuar në Planin Strategjik të Turizmit 2018-2028

dhe ato të huaj – projekti do të krijojë mjete dhe mundësi për turistët për identifikimin e lehtësirave për të vizituar atraksionet kryesore që zona ka.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e projektit do të përdoret një metodë gjithëpërfshirëse. Projekti e konsideron tepër të rëndësishme zhvillimin dhe promovimin e produkteve të reja të turizmit në këtë zonë alpine me përfshirjen e drejtpërdrejtë të fermerëve dhe komunitetit vendas. Në mënyrë që të rritet numri i turistëve në këtë zonë është e rëndësishme për fermerët lokalë të mësojnë se si të përmirësojnë shërbimin ndaj klientit, si një bazë për industrinë e turizmit.

Gjatë hartimit të konceptit idesë grupi i projektit u njoh dhe morri parasysh nevojat e grupeve të synuara dhe përfituesve përfundimtarë, si dhe sfidat që pengojnë përmbushjen e këtyre nevojave. Zhvillimi socio-ekonomik dhe jetesa e grupeve të synuara dhe përfituesve ndikohet në një shkallë të madhe nga papunësia, varësia e lartë nga të ardhurat bujqësore dhe jetesa në zonat e largëta rurale. Duke qenë se rajoni ka potencial të lartë zhvillimi dhe është i pashfrytëzuar bën që grupet e synuara dhe përfituesit të jenë evident dhe zvogëlon dukshëm edhe konkurrencën e rajonit.

Grupi i projektit e konceptoi atë, duke marrë parasysh sfidat dhe mundësitë e mëdha sociale dhe mjedisore. Ata identifikuan dhe zhvilluan në bashkëpunim me partnerët lokal një prezantim rreth mundësive, sfidave dhe projekteve aktuale për të kuptuar dhe planifikuar më mirë zhvillimin e zonës nga perspektiva e turizmit. Qëllimi ishte të shmangnin aktivitete paralele dhe të identifikonin aktivitete plotësuese që do të mbështesin zhvillimin e plotë të zonës së synuar të projektit përmes zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta.

#### Objektivat specifike të projektit për krijimin e një ekonomie të qëndrueshme lokale në Radomirë:

Ky projekt do të mbështetet në iniciativat e mëparshme të zbatuara nga Bashkia Dibër veçanërisht në përvojën dhe eksperiencën e mirë për përshtatjen e bujtinave dhe trajnimin e komuniteteve lokale për ofrimin e shërbimeve në bujtina. Aktivitetet e projektit do të fokusohet në ringjalljen e kulturës tradicionale të komunitetit lokal që jetojnë në Radomirë në ndërtimin e bujtinave të cilat kanë një vlerë unike si dhe nxitëse për të gjitha llojet e turizmit (natyra, turizmi kulturor dhe historik) dhe zhvillohen dhe ofrojnë një produkt unik për turistët.

Veprimi i propozuar synon:

- I. Vlerësimi i mundësive të Eko-turizmit në zonën e Radomirës përmes përmirësimit të shërbimeve lokale pjesë të shtigjeve aktuale turistike.
- II. Zhvillimi i turizmit mbështetur në Komunitet dhe promovimi i Eko-turizmit nëpërmejt promovimit të shtigjeve turistike të aritshme për turistët në fashtin Radomirë.

### 2.3 Përshkrimi i projektit

Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor Radomira paraqitet si një fshat turistik i cili ka potencial të lartë për zhvillimin e turizmit të aventurës<sup>16</sup>. Pavarësisht potencialit turistik bazuar në planin Social të Bashkisë Dibër ky fshat karakterizohet nga një sërë problematikash<sup>17</sup>:

- Një shkallë relativisht e lartë emigrimi, kryesisht të rinj.
- Papunësi dhe vështirësi ekonomike, 40% e popullsisë trajtohet me ndihmë ekonomike.
- Angazhim në ekonomi ilegale si kultivimi kanabisit si rezultat i mungesave të alternativave.

Të gjitha këto problematika vijnë si rezultat i një ekonomie lokale tepër të brishtë e bazuar kryesisht tek blegtoria dhe shumë pak te turizmi pavarësisht lidhjes që egziston midis këtyre dy sektorëve.

Nëpërmejt këtij projekti synohet që të hidhen bazat e një ekonomie të qëndrueshme lokale e cila lidhet drejtpërdrejt me dy sektorët ekonomik të kësaj zone turizmi dhe blegtoria. Gajllërimi i ekonomisë rurale të Radomirës do të kishte një impakt kondravers me problematikat e sipërpërmendura. Pavarësisht se emigrimi, papunësia, vështirësitë ekonomike dhe ekonomia ilegale janë problematika të kanalizuar ndër vite në Radomirë ky projekt vejn si një fije shprese për komunitetin lokal si një ndër përfituesit kryesor të këtij projekti.

*Ky projekt ka si qëllim që të ofrojë mundësi për zhvillimin e ekonomisë lokale përmes Eko-Turizmit, nëpërmejt zhvillimit të shërbimeve dhe produkteve turistike të fshatit Radomirë si një mundësi për banorët e zonës. Projekti do të përqëndrohet gjithashtu zhvillimin dhe promovimin e produkteve të reja turistike në fshatin turistik të Radomirës me përfshirjen e drejtpërdrejtë të komuniteteve lokale.*

Treguesit e synuar në fund të periudhës së zbatimit të projektit për objektivin e përgjithshëm janë:

- Të ardhurat e familjes në zonën e projektit janë rritur me 20% përmes ofrimit të shërbimeve të përmirësuara në fushën e turizmit.
- Rritja e numrit të turistëve me 20% dhe rritja e kohëzgjatjes së vizitave të tyre (më shumë se 2 netë), duke vizituar zonën dhe duke kontribuar në rritjen e zhvillimit ekonomik në fushën e turizmit.

Ky projekt do të mbështetet në aktivitetet e mëparshme të implementuara nga Bashkia Dibër, veçanërisht në përvojën e mirë të krijimit/adaptimit dhe trajnimit të bujtinave për ofrimin e shërbimeve. Ai gjithashtu do të përqëndrohet në ringjalljen e kulturës tradicionale të komuniteteve lokale.

Përshkrimi i detajuar i rezultateve, aktiviteteve dhe roli i secilit partner në zbatimin e tyre:

Bazuar në objektivat e vendosuar për projektin dhe për përmbushjen brenda afatit të përcaktuar të aktiviteteve ato do të organizohen në 2(dy) Working Package. Implementimi i aktiviteteve në të 2-ja WP do të nisi paralelisht me lançimin e projektit.

**WP.1. Vlerësimi i mundësive të Eko-turizmit në zonën e Radomirës përmes përmirësimit të shërbimeve lokale pjesë të shtigjeve aktuale turistike.**

Treguesit e synuar për objektivin 1(një) në fund të periudhës të zbatimit janë:

- R1.1 Një studim i realizuar rreth grupeve të interesit dhe nevojave të tyre.
- R1.2 Një pikë e informacionit turistik (Eco-Friendly) e ndërtuar dhe e pajisur me informacion turistik dhe mundësitë që ofron Radomira.
- R1.3 Tre Pika-Pushimi përgjatë shtegut të Malit të Korabit të ngritura dhe funksionale në orjentimin dhe ofrimin shërbimeve bazë për turistët.
- R1.4 Shtegu drejt destinacionit të Liqenit të Zi prej 1.5 km, i hapur dhe i konstruktuar me kalldrëm.

Supozimet kryesore të bëra për rezultatet e aktiviteteve nën objektivin SO1 janë:

Rezultatet dhe aktivitetet e parashikuara të lidhura me objektivin SO1 janë të lidhura drejtpërdrejt me nevojat e komunitetit. Për të minimizuar rreziqet që dalin nga ky supozim, projekti dhe ekipi i angazhuar me shkrimin e tij siguroi

<sup>16</sup> Plani i Përgjithshëm vendor Bashkia Dibër 2018-2030

<sup>17</sup> Bazuar në Planin Social, Bashkia Dibër 2018-2021

përafrimin e plotë të projektit me nevojat e Komunitetit, me Strategjinë e Turizmit, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe dokumentet rajonale të miratuara në bashkinë Dibër.

**WP.2. Zhvillimi i turizmit mbështetur në Komunitet dhe promovimi i Eko-turizmit nëpërmjet promovimit të shtigjeve turistike të aritshme për turistët në fashtin Radomirë.**

Treguesit e synuar për objektivin 2 (dy) në fund të periudhës të zbatimit janë:

- R 2.1. Dhjetë ofrues lokal shërbimesh të trajnuar rreth ofrimit të shërbimeve turistike dhe mikpritjes.
- R 2.2. Një spot promovues për atraksionet dhe produktet turistike të fshatit Radomirë.
- R2.3. Mbyllja e projektit me aktivitetin "Dita e Bjeshkatarëve të Ballkanit"

Supozimet kryesore të bëra për rezultatet e aktiviteteve nën objektivin SO2 janë:

Mungesa e angazhimit nga grupet e interesit në këto aktivitete dhe nevoja për një ekspertizë të lartë në fushën e agro dhe eko-turizmit. Për të shmangur mungesën e interesit nga ky target grup që projekti e kanë fokus, ekipi i cili është angazhuar në shkrimin e projekt propozimit ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me grupet e interesit dhe ka marrë në konsideratë sugjerimet e tyre. Për të patur një ekspertizë sa më të mirë në mënyrën se si të mbështesim agro dhe eko-turizmin në një fshat turistik duke hedhur bazat e një ekonomie të qëndrueshme lokale projekti do të mbështetet tek partneri, ANRD i cili ka një experience të sukseshme disa vjeçare në këtë fushë.

Aktorët kryesorë përfshirë stafin e bashkisë janë të përkushtuar dhe të aftë për të realizuar me sukses aktivitetet e parashikuara. Në mënyrë që të minimizohen rreziqet që dalin nga ky supozim, partneriteti dhe koordinimi me aktorët lokal siguron mbështetjen e aktorëve kryesorë në fillim të zhvillimit të projektit. Të gjithë aktorët kryesorë janë konsultuar (takime, intervista) gjatë përgatitjes së projektit dhe aktivitetet e projektit pasqyrojnë kërkesat, nevojat dhe kapacitetet e tyre për të mbështetur projektin.

Rezultatet, Aktivitetet dhe Indikatorët:

Një përshkrim i detajuar i secilit rezultat, aktivitet dhe tregues jepet në Tabelën 1. Treguesit e projektit kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me treguesit e përcaktuar në thirrjen nga RDPA.

<b>O1. Vlerësimi i mundësive të Eko-turizmit në zonën e Radomirës përmes përmirësimit të shërbimeve lokale pjesë të shtigjeve aktuale turistike.</b>	
<i>Rezultati: 1.1. Një studim i realizuar rreth grupeve të interesit dhe nevojave të tyre.</i>	Indikatorët: -Numri i stekholderarave të identifikuar që operojnë në fushën e agro-turizmit. -Numri i pyetësorëve të realizuar. -Numri i takimeve me komunitetin lokal të zonës. -Të dhënat e mëparshme dhe analiza e të dhënave aktuale.
Aktivitetet: 1.1.1. Identifikimi i grupeve të interesit lokal që operojnë në fushën e agro dhe eko-turizmit dhe produkteve turistike të zonës. 1.1.2. Krijimi i databazës të grupeve të interesit sipas fushës ku ato operojnë dhe rrjetëzimi i tyre.	
Përshkrimi i Aktivitetit Këto aktivitete do të realizohet nga ANRD në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Dibër si drejtues i projektit. Ky studim i ndërmarë do të nxjerrë në pah se cilat janë grupet e interesit, produktet dhe vlerat historike të zonës që kanë nevojë të mbështeten për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në këtë zonë rurale. Ky rezultat do të arrihet nëpërmjet takimeve në grup dhe one-on-one ku do të identifikohet dhe krijohet një databazë e plotë e grupeve të interesit të cilët do të jenë subjekt i aktiviteteve të projektit. Karahas identifikimit të grupeve të interesit ky aktivitet do të nxjerrë në pah nevojat për trajnime dhe ritje kapacitetesh që strukturat lokale që ofrojnë shërbime në fushën e turizmit kanë nevojë, gjë e cila do t'i shërbejë krijimit të kushteve për zhvillimin e një ekonomie rurale të qëndrueshme. Ky aktivitetet do të realizohet nga ANRD si partner i Bashkisë Dibër në këtë projekt bazuar edhe në eksperiencën e tyre në këtë fushë.	
Kohëzgjatja e aktivitetit: muaji i 2-të	ANRD

<p><u>R1.2. Një pikë e informacionit turistik (Eco-Friendly) e ndërtuar dhe e pajisur me informacion turistik dhe mundësitë që ofron Radomira.</u></p>	<p>Indikatorët: -Numri i konsultimeve dhe intervistave. -Specifikat rreth projektit Inxhinjerik. -Numri i materialeve promovuese të realizuara. -Numri i shërbimeve të ofruara.</p>
<p>Aktiviteti: 1.2.1 Dizenjimi dhe ngritja e Pikës të Informacionit Turistik (Eco-Friendly). 1.2.2 Dizenjimi dhe ekspozimi i materialeve promovuese në Pikën e Informacionit Turistik.</p>	
<p>Përshkrimi i Aktivitetit Pika e informacionit turistik do të ndërtohet me materiale ekologjike, kryesisht dru. Kjo pikë informacioni turistik do ketë një dizajn ekologjik dhe inovativ dhe do të jetë e pajisur me të gjitha materialet e nevojshme për informimin, orjentimin dhe promovimin e Radomirës si një destinacion turistik. Ky Info-Point do të jetë lehtësisht i identifikueshëm sepse do të vendoset pranë qendrës të fshatit apo në fillimn e shtegut kryesor drejt malit të Korabit dhe do të shërbej për të krijuar impaktin e parë rreth asaj se çfarë ofron Radomira. Një risi tjetër e kësaj pike do të jetë edhe partneriteti me sipërmarrjet lokale, ku kjo pike do të promovoj produktet e sipërmarrjeve lokale të zonës pranë saj. Kësaj pike të informacionit turistik do t'i shtohet edhe opsioni Free-Wi-Fi. Ky aktivitet do të realizohet nga Bashkia Dibër bazuar në eksperiencën e tyre në fushën e ndërhyrjeve infrastrukturore.</p>	
<p>Kohëzgjatja e aktivitetit: Nga muaji 3 deri në muajin 8</p>	<p>Bashkia Dibër</p>
<p><u>Rezultati 1.3. Tre Pika Pushimi përgjatë shtegut të Malit të Korabit të ngritura funksionale në orientimin dhe ofrimine shërbimeve bazë për turistët.</u></p>	<p>Indikatorët: -Numri i pikave të pushimit të identifikuar dhe dokumentuara. -Numri i pikave të pushimit të ngritura. -Numri i materialeve promovuese të vendosura në këto pika.</p>
<p>Aktiviteti: 1.3.1. Identifikimi i 3 pikave kryesore të pushimit përgjatë shtegut turistik të Malit të Korabit. 1.3.2. Dizenjimi dhe ndërhyrja për ngritjen e 3 Pikave të Pushimit (Eco-Friendly) përgjat shtegut turistik të Malit të Korabit.</p>	
<p>Përshkrimi i Aktivitetit: Një ndër arsyet pse turistët vizitojnë Radomirën është sepse ky fshat ofron pikën dhe shtegun më të afërt për ngjitjen në malin e Korabit. Pavarësisht se shtegu është i markuar prej vitesh vihet re mungesa e strukturave apo pikave të pushimit dhe udhëzues rreth shtegut për turistët. Njëpërmejt mbështetjes nga projekti do të realizohet ngritja e 3 Eko-Pikave të pushimit për turistët të cilat do të ofrojnë këto shërbime: - Informacion - Mundësi për çlodhje - Ndihmën e shpejtë - Pikë për karikimin e paisjeve elektornike. Ky aktivitet do të realizohet nga drejtuesi i projektit në bashkëpunim me partnerin e tij ku identifikimi i pikave strategjike të pushimit do të kryhet nga partnerët ndërsa ndërhyrja infrastrukturore do të realizohet nga Bashkia.</p>	
<p>Kohëzgjatja e aktivitetit: Nga muaji 3 deri në muajin e 8</p>	<p>Bashkia Dibër ANRD</p>
<p><u>Rezultati R1.4 Shtegu drejt destinacionit të Liqenit të Zi prej 1.5 km i hapur dhe i konstruktuar me kalldrëm.</u></p>	<p>Indikatorët: -Gjatësia e shtegut në km</p>
<p>Aktiviteti: 1.4.1 Dizenjimi i projektit inxhinjerik të ndërhyrjes në shtegun e Liqenit të Zi. 1.4.2 Të shënjoj gjurmën e shtegut prej 1.5 km drejt Liqenit të Zi dhe të konstrukttoj këtë shteg me kalldrëm.</p>	
<p>Përshkrimi i Aktivitetit: Liqeni i Zi në Radomirë është një ndër destinacionet kryesore turistike që vizitohet si nga turistët vendas po ashtu edhe nga ato të huaj. I gjendur rreth 1.5 km nga fshati kjo zonë është frekuentuar tradicionalisht si një destinacion</p>	

<p>për eskursione dhe kamping. Nëpërmjet hapjes dhe ndërtimit të këtij shtegu me kalldrëm aksesit do të jetë më i lehtë dhe turistët që vizitojnë Radomirën dhe ngjisin Malin e Korabit do të kenë më shumë mundësi për t'a vizituar këtë destinacion. Nëpërmjet kësaj ndërhyrje ky shteg do të pajiset me të gjithë infrastrukturën përkatëse dhe mbështetëse që një shteg turistik ka nevojë. Në pikën më të lartë të shtegut do të ngrihet një pikë vëzhgimi nga i cili mund të shikosh të gjitha bukuritë që natyra i ka falur Radomirës si një fshat turistik alpin. E gjithë infrastruktura do të ndërtohet duke përdorur materiale të cilat gjenden në zonë duke bërë që të ruhet autenticiteti i zonës. Falë promovimit nga institucionet e vetëqeverisjes vendore ky shteg sëbashku me shtegun e Malit të Korabit pritet të kthehen në një ndër destinacionet më të vizituara në Dibër dhe rajon. Ky aktivitet do të realizohet nga Bashkia Dibër e cila do të realizojë punimet duke kontraktuar një kompani nëpërmjet një procedure të hapur të prokurimit publik.</p>	
Kohëzgjatja e aktivitetit: Nga muaji 3 deri në muajin e 9	Bashkia Dibër
<p><b>O2. Zhvillimi i turizmit mbështetur në Komunitet dhe promovimi i Eko-turizmit nëpërmjet promovimit të shtigjeve turistike të aritshme për turistët në fshatin Radomirë.</b></p>	
<p><u>Rezultati 2.1. Dhjetë ofrues lokal shërbimesh të trajnuar rreth ofrimit të Shërbimeve turistike dhe mikpritjes.</u></p>	Indikatorët: -Numri i trajnimeve të ndërmarra në këtë fushë. -Numri i pjesëmarrësve në trajnime.
<p>Aktivitetet: 2.1.1. Ritja e kapaciteteve dhe trajnimi i 10 sipërmarrësve lokal rreth ofrimit të shërbimeve turistike dhe përmirësimit të shërbimeve aktuale.</p>	
<p>Përshkrimi i Aktivitetit: Bazuar në vlerësimin e situatës dhe nevojat banorëve do të realizohet një paketë trajnimesh në fushën e shërbimeve agro-turistike. Kjo paketë trajnimesh do të rrisë kapacitetin e burimeve njerëzore dhe do të përmirësojë ofertën turistike që kjo zonë ofron. Realizimi i trajnimeve do të mbështet në një numër aktivitetesh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i manualeve të trajnimeve me tematika të caktuara.</li> <li>- Përzgjedhja e pjesëmarrësve.</li> <li>- Ofrimi i trajnimeve.</li> <li>- Çertifikimi dhe lënja e rekomandimeve për përmirësime.</li> </ul> <p>Ky aktivitet do të realizohet nga partneri i Bashkisë Dibër në këtë projekt bazuar edhe në eksperiencën e tyre në këtë fushë.</p>	
Kohëzgjatja e aktivitetit: Nga muaji 3 në muajin e 7.	ANRD
<p><u>Rezultati 2.2. Një spot promovues për atraksionet dhe produktet turistike të fshatit Radomirë.</u></p>	Indikatorët: -Numri i atraksioneve turistike të promovuara. -Numri i spoteve të realizuara.
<p>Aktiviteti: 2.2.1. Realizimi i një spoti promovues për zonën dhe mundësitë që ajo ofron.</p>	
<p>Përshkrimi i Aktivitetit: Një spot promovues rreth asaj çfarë Radomira ofron për turistët dhe pse ajo duhet vizituar. Spoti promovues do të promovojë produktet dhe shërbimet kryesore të zonës në një masë të gjerë dhe duke i bërë ato të njohura për vizitorët potencial. Realizimi i videos promovuese do të mbështet në disa nga elementët kryesorë që e bëjnë Radomirën një fshat turistik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monumentet Natyrore.</li> <li>- Trashëgimia kulturore dhe traditat e zones.</li> <li>- Investimet e realizuara nga projekti dhe donator të ndryshëm.</li> </ul> <p>Spoti promovues do të shfaqet në të gjitha mediat lokale të Dibrës duke e bërë të aritshëm për publikun dhe vizitorët potencialë.</p>	
Kohëzgjatja e aktivitetit: Muaji 9	Bashkia Dibër

<b>Rezultati: R2.3. Mbyllja e projektit me aktivitetin "Dita e Bleshkatarëve të Ballkanit".</b>	<b>Indikatorët:</b> -Numri i pjesëmarrësve në aktivitet.
<b>Aktiviteti:</b> 2.3.1. Realizimi i një aktiviteti përmblylës për projektin	
<b>Përshkrimi i Aktivitetit:</b> Realizimi i aktiviteti përmblylës të projektit i cili krahas finalizimit të të gjitha aktiviteteve dhe investimeve të realizuara në zonë do të shërbejë për ta promovuar atë në shkallë rajonale. Aktiviteti konsiston në realizimin e ngjitjes për në malin e Korabit në 3 anët e kufirit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova duke u takuar në majë si një simbolikë e miqësisë dhe fqinjësisë të mirë si dhe bashkëpunimit dhe zhvillimit të përbashkët rajonal.	
<b>Kohëzgjatja e aktivitetit:</b> Në muajin 10	<b>Bashkia Dibër</b>

Egziston një lidhje e drejtpërdrejt midis objektivave të thirrjes dhe indikatorëve apo fushave të ndërhyrjes që thirrja për projekte nga donatori RDPA synon të mbështesë. Kjo lidhje midis objektivave të projektit dhe indikatorëve të thirrjes paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<b>Lidhja e Indikatorëve të thirrjes për projekt propozime me objektivat e projektit.</b>	
	<b>Indikatorët e projektit që lidhen me thirrjen.</b>
<b>Objektivi i përgjithshëm:</b> Të ofrojë mundësi për zhvillimin e ekonomisë lokale përmes Eko-Turizmit, nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve dhe produkteve turistike të fashatit Radomirë si një mudësi për banorët e zonës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i ndërhyrjeve infrastrukturore të lehta turistike.</li> <li>- Numri i ndërhyrjeve të lehta infrastrukturore për të krijuar një produkt turistik.</li> <li>- Numri i ndërhyrjeve që fokusohen në promovimin e aktiviteteve ekonomike dhe të produkteve artizanale.</li> <li>- Numri i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të ndërveprimit social.</li> <li>- Numri i ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës të lehtë për shërbimet publike.</li> </ul>
<b>O1. Vlerësimi i mundësive të Eko-turizmit në zonën e Radomirës përmes përmirësimit të shërbimeve lokale pjesë të shtigjeve aktuale turistike.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i ndërhyrjeve infrastrukturore të lehta të realizuara.</li> <li>- Numri i shërbimeve të ofruara të përmirësuara.</li> <li>- Numri i pikave të pushimit të identifikuar/dokumentuar.</li> <li>- Numri i pikave të pushimit të ngritura.</li> <li>- Numri i materialeve promovuese të realizuara.</li> <li>- Numri i shtigjeve në të cilat është përmirësuar aksesimi.</li> </ul>
<b>O2. Zhvillimi i turizmit mbështetur në Komunitet dhe promovimi i Eko-turizmit nëpërmjet promovimit të shtigjeve turistike të aritshme për turistët në fashatin Radomirë.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i strukturave akomoduese artizanale të identifikuar.</li> <li>- Numri i ndërhyrjeve dhe suporti i ofruar për të promovuar produktet artizanale e tradicionale të zonës.</li> <li>- Numri i trajnimeve të ndërmarra për rritjen e kapaciteteve dhe ndërveprimit social në fushën e ofrimit të shërbimeve turistike.</li> <li>- Numri i aktiviteteve promovuese të ndërmarra.</li> <li>- Numri i videove dhe spoteve promovuese të realizuara.</li> <li>- Numri i atraksioneve turistike natyrore dhe kulturor të promovuara.</li> </ul>

### 2.3.1 Rëndësia e projektit

Jepni informacionin e dhënë për rëndësinë e projektit siç është evidentuar paraprakisht në projekt ide.

Projekti "Ekonomia e Gjelbërt si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën" është në të njëjtë linjë me fushat e ndërhyrjes që Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri synon. Nëpërmjet ngritje të Eco-pikës të informacionit turistik, ngritjen e pikave të pushimit përgjat shtegut turistik të Korabit dhe promovimin e zonës nëpërmejt aktiviteteve dhe spoteve televizive projekti synon të risi **potencialin turistik të fshatit të Radomirës**. Suporti për trajnimin rreth shërbimeve në shtëpitë pritëse dhe sipërmarrjet lokale do të shërbej si një pikë nisje për **zhvillimin e ekonomisë vendore dhe sigurimin e qëndrueshmësisë ekonomike** nëpërmjet nxitjes të vetëpunësimit në sektorin e turizmit dhe agro-turizmit. Trajnimet për përmirësimin e paketës të shërbimeve si dhe konsultimi rreth nevojave me komunitetin do të risi **kapacitetet dhe ndërveprimin social** midis banorëve me njëri-tjetrin dhe midis banorëve dhe turistëve në tërësi. Investimet infrastrukturore të projektit të bazuara edhe në planin e përgjithshëm vendor do të **përmirësojë shërbimet publike** që ofrohen në këtë zonë. Egziston një sinergji midis objektivave të projekt propozimit dhe objektivit të thirrjes për krijimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme e cila vjen si një mundësi e pashfrytëzuar bazuar në burimet natyrore që Radomira ka.

Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor Radomira paraqitet si një fshat turistik i cili ka potencial të lartë për zhvillimin e turizmit të aventurës . Pavarësisht potencialit turistik bazuar në planin Social të Bashkisë Dibër ky fshat karakterizohet nga një sërë problematikash :

- Një shkallë relativisht e lartë emigrimi, kryesisht të rinj.
- Papunësi dhe vështirësi ekonomike, 40% e popullsisë trajtohet me ndimë ekonomike.
- Angazhim në ekonomi ilegale si kultivimi kanabisit si rezultat i mungesave të alternativave.

Të gjitha këto problematika vijnë si rezultat i një ekonomie lokale tepër të brishtë e bazuar kryesisht tek blegtoria dhe shumë pak te turizmi pavarësisht lidhjes që egziston midis këtyre dy sektorëve.

Nëpërmejt këtij projekti synohet që të hidhen bazat e një ekonomie të qëndrueshme lokale e cila lidhet drejtëpërdrejt me dy sektorët ekonomik të kësaj zone turizmi dhe blegtoria. Gjallërimi i ekonomisë rurale të Radomirës do të kishte një impakt të drejtëpërdrejtë kondravers me problematikat e sipërpërmendura. Pavarësisht se emigrimi, papunësia, vështirësitë ekonomike dhe ekonomia ilegale janë problematika të kanalizuar ndër vite në Radomirë ky projekt vejn si një fije shprese për komunitetin lokal si një ndër përfituesit kryesor të këtij projekti.


Projekti "Ekonomia e Gjelbërt si një mundësi zhvillimi SMART për Radomirën" është në të njëjtë linjë me Programin 100 Fshatrat të ndërmarrë që nga viti 2018 nga Qeveria Shqiptare falë të cilit u bë e mundur ndërtimi i rrugës lidhëse të fshatit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë viti 2020. Ky projekt është gjithashtu në të njëjtën linjë me Planin e Përgjithshëm Vendor bazuar në studimet e të cilit Dibra ka katër fshatra me potencial të lartë turistik por Radomira paraqitet si ndër fshatrat me potencial më të lartë dhe strategjik. Rruga e Arbrit gjithashtu do të lehtësojë vështirësitë infrastrukturore të hasura deri më tani duke e sjellur Radomirën shumë pranë Tiranës dhe duke e kthyer në një destinacion turistik rajonal.

